

Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH zhvillon në Universitetin “Eqrem Çabej” workshop-in për planin e auditimit në vitin 2025

Më datë 1 nëntor 2024, Departamenti i Auditimit të Performancës finalizoi në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë procesin e përgatitjet të temave të auditimit për vitin 2025.

Në këtë takim morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm znj. Marjola Llanaj, drejtues të departamenteve të auditimit në KLSH dhe audituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës. Pjesëmarrës në këtë takim ishin Prof. Dr. Jaho Cana, Rektor i Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, pedagogë dhe studentë të këtij universiteti.



Takimi u hap me fjalën e Drejtoreshës së Përgjithshme znj. Marjola Llanaj e cila paraqiti rëndësinë e procesit të planifikimit të auditimeve për vitin pasardhës që KLSH do të realizojë dhe rëndësinë e bashkëpunimit me universitet. Në diskutime, Drejtoresha e Përgjithshme u ndal në mënyrën e paraqitjes sa më thjeshtë të procesit të planifikimit të hartimit të temave të auditimit, për ta bërë atë sa më të kuptueshme për studentët, pjesëmarrësit, si dhe në përgatitjen dhe paraqitjen e temave të auditimit me impakt të madh social, kjo në vijimësi të punës së deri më tanishme të KLSH-së. Gjithashtu, në emër të Kryetarit, Drejtoresha e Përgjithshme përcolli mesazhin e tij për Universitetin e Gjirokastrës, për të zgjeruar dhe forcuar bashkëpunimin mes dy institucioneve, jo vetëm në fushën e auditimit, por edhe në fusha të tjera me interes. Ajo theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi për të ndihmuar në përmirësimin e proceseve dhe standardeve në universitet, si dhe për të krijuar mundësi që studentët të angazhohen në projekte praktike dhe studimore të lidhura me kontrollet financiare dhe administrative, nëpërmjet ndjekjes nga afër të punës së KLSH-së. Kjo synon të forcojë lidhjet midis botës akademike dhe KLSH-së për të qenë sa më afër problematikave dhe shqetësimeve që studentët përballen si në aspektin e arsimimit të tyre dhe në atë social.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË
PERFORMANCËS

**PROPOZIME
PËR AUDITIME
PERFORMANCE PËR PLANIN
VJETOR TË AUDITIMIT
2025**

Gjirokastër, Albania 1 Nëntor 2024

www.klsh.org.al

Takimi u përshëndet nga Rektori i Universitetit, i cili foli për rëndësinë e bashkëpunimit me Kontrollin e Lartë të Shtetit, duke e vlerësuar atë si një hap të rëndësishëm dhe një risi për institucionin. Ai theksoi se ky bashkëpunim do të sjellë përfitime të shumta duke kontribuar në ngritjen e transparencës dhe përmirësimin e standardeve akademike dhe administrative. Gjithashtu, shtoi se organizimi i workshop-eve dhe bashkëpunimeve të mëtejshme, do t'u ofrojë studentëve mundësi të reja për të zhvilluar aftësitë e tyre praktike dhe njohuritë në fushën e auditimit dhe kontrollit financiar, duke e bërë universitetin një pikë të rëndësishme referimi në këto fusha.

Takimi u vijua me paraqitjen nga z. Alfred Zylfi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të performancës, të përmbledhjes së gjithë procesit të realizimit, planifikimit të temave të auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Performancës, ku përshkruhet në mënyrë të detajuar i gjithë procesi i përgatitjes së temave të auditimit performance, të cilat audituesit mendojnë të përfshihen në planin vjetor të auditimeve për vitin 2025, si dhe u paraqitën fushat me temat e auditimit. Gjithashtu, gjatë takimit u prezantuan edhe disa nga temat e auditimit të realizuara nga audituesit gjatë këtij viti.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË
PERFORMANCËS

**PROPOZIME
PËR AUDITIME
PERFORMANCE PËR PLANIN
VJETOR TË AUDITIMIT
2025**

Gjirokastër, Albania 1 Nëntor 2024

www.klsh.org.al

Në këtë takim pjesëmarrësit vlerësuan problematikën e ngritur, e cila synon të nxisë llogaridhënien e stimulimin e transparencës. Pedagogu i universitetit Dr. Dritan Rami kërkoi

të mundësohet një auditim mbi zbatimin e kontratave të përfshirjes në praktikat mësimore të studentëve të infermierisë në Spitalin Rajonal të Gjirokastrës.

Gjithashtu, audituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës zhvilluan vizita në Shtëpinë Muze të Kadaresë, Muzeun Etnografik, Pazarin e Vjetër të qytetit të Gjirokastrës etj.